



VENDIM

Nr. 110 Datë 21.10.2011

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR KUSHTET MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT TË
SHPËRNDARJES DHE SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 dhe 9, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionereve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.10.2011, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të saj dhe relacionin përkatës,

Vendosi:

1. Të miratojë rregulloren për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike. (Rregullorja, bashkëngjitur këtij vendimi).
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë CEZ Shpërndarje sh.a për vendimin e Bordit të Komisionerëve.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi në 1 Janar 2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI